



MANUALI I ZOTËRUESIT

LG TONE Free

Kufje stereo LG me Bluetooth®

Për sigurinë dhe lehtësinë e përdoruesit, ju lutemi lexoni manualin e përdorimit përpara se ta përdorni produktin.

Modeli


TONE-T60Q

Udhëzues i shpejtë

| Si ta përdorni lehtë

1. Lidhja e smartfonit me kufjet me Bluetooth (→ Ju lutemi referojuni "Lidhja e smartfonit me kufjet përmes Bluetooth" në faqen 8.)

- 1 Shtypni aplikacionin e cilësimeve [⚙️] të smartfonit. Më pas zgjidhni Bluetooth dhe aktivizoni funksionin Bluetooth. (☐ Çaktivizo > ☑️ Aktivizo)
- 2 Hapni kapakun me kufjet të vendosura në kutinë e karikimit. Treguesi blu i statusit të baterisë në pjesën ballëre pulson. Nëse drita blu e statusit të baterisë nuk pulson ose nëse dëshironi të lidhni një pajisje të ndryshme nga ajo e lidhur tashmë, prekni dhe mbani prekur fushën me prekje në kufjen e majtë ose të djathtë për 3 - 5 sekonda.



- 3 Kur dritarja njoftuese e lidhjes së Çiftimit të shpejtë të shfaqet në fund të ekranit të smartfonit, prekni lehtë mbi të për t'u lidhur.
- 4 Nëse dritarja njoftuese e lidhjes nuk shfaqet, kërkoni për [TONE-T60Q] në menunë Bluetooth® të smartfonit dhe prekeni.
 - TONE-T60Q_LE nuk është një emër i vlefshëm i modelit në listën e pajisjeve të lidhjes me Bluetooth®. Kontrolloni emrin e modelit që po përdorni dhe lidheni me emrin e modelit i cili nuk përmban "LE".

2. Përdorimi i kufjeve me prekje (→ Ju lutemi referojuni në "Dëgjimi i muzikës", "Pranimi i telefonatës" dhe "Dëgjimi i tingullit të ambientit/Anulimi aktiv i zhurmës (ANC)" në faqet 11, 12 dhe 13.)

Mund t'i prekni kufjet për të luajtur ose për të ndaluar muzikën, ose për të marrë ose refuzuar një telefonatë. Mund ta ndryshoni mënyrën se si punon funksioni në cilësimet e fushës me prekje të aplikacionit LG TONE Free.

Pranimi i telefonatës

| Si ta përdorni | Telefononi |
|---|---------------------------|
| <input type="radio"/> Prekni një herë | Pranimi i telefonatave |
| <input checked="" type="radio"/> Prekni dy herë | Ndërprerja e telefonatave |
| <input type="radio"/> Prekni dhe mbani shtypur | Refuzimi i telefonatave |

Dëgjimi i muzikës

| Si ta përdorni | Luaj |
|---|---|
| <input type="radio"/> Prekni një herë | Luaj/Ndalo |
| <input checked="" type="radio"/> Prekni dy herë | Ulni volumnin (prek majtas) Ritri volumnin (prek djathtas) |
| <input type="radio"/> Prekni tre herë | Kënga e radhës |

Dëgjimi i tingullit të ambientit/Anulimi aktiv i zhurmës (ANC)

| Si ta përdorni | Dëgjimi i tingullit të ambientit/Anulimi aktiv i zhurmës (ANC) |
|--|--|
| <input type="radio"/> Prekni dhe mbani shtypur | Ndryshoni funksionin |

3. Karikimi (→ Ju lutemi referojuni "Karikimi nëpërmjet kablos" dhe "Përshkrimi mbi UVnano" në faqet 14 dhe 15.)

Karikimi me kabllo

Lidhni kabllo e karikimit për të karikuar kutinë e karikimit me kufjet. Kufjet dhe kutia e karikimit karikohen njëkohësisht.

- Nëse e karikoni pajisjen me kufjet e vendosura dhe kapakun e mbyllur, llamba LED UVnano funksionon për 10 minuta.

⚠ Kujdes

- Ju lutemi, vini re se temperatura e kufjeve mund të rritet ndërsa llamba LED UVnano është në punë.
-

4. Lidhja e aplikacionit LG TONE Free (→ Ju lutemi referojuni "Lidhja me aplikacionin LG TONE Free" në faqen 17.)

- 1 Kërkoni për "LG TONE Free" në platformën Google Play Store ose App Store në smartfonin tuaj ose skanoni më poshtë kodin QR për të instaluar aplikacionin LG TONE free.
- 2 Ekzekutoni aplikacionin për të përdorur funksione të ndryshme (kontrolli i baterisë së kufjeve, njoftimi zanor, ndryshimi i regjimit të barazimit, kontrolli i informacionit mbi vendndodhjen e lidhjes së fundit, kërkimi i kufjeve të mia me valë, etj.) Mbështetet vetëm Android 7.0 dhe iOS 13 ose versione më të reja.



<Android>



<iOS>

Udhëzues i shpejtë

- 2 Si ta përdorni lehtë

Eksplorimi i produktit

- 6 Kutia e karikimit
- 7 Kufjet

Lidhja me Bluetooth për përdorim

- 8 Lidhja e smartfonit me kufjet përmes Bluetooth
- 9 Lidhje të Shumëfishta
- 9 Rilidhja automatike

Dëgjimi i zërit me kufje

- 10 Mbajtja në vesh e kufjeve
- 11 Dëgjimi i muzikës
- 12 Pranimi i telefonatës
- 13 Dëgjimi i tingullit të ambientit/Anulimi aktiv i zhurmës (ANC)

Karkimi

- 14 Karkimi nëpërmjet kabllot
- 15 Përshkrimi mbi UVnano
- 16 Kontrolli i gjendjes së baterisë

Lidhja me aplikacionin Bluetooth

- 17 Lidhja me aplikacionin LG TONE Free

Masat paraprake të sigurisë

- 18 Njoftimet dhe Paralajmërimet e Sigurisë
- 19 Masat paraprake kur përdorni produktin

Çfarë duhet të kontrolloni përpara se të raportoni ndonjë keqfunksionim

- 20 Zgjidhja e problemeve

Shtojcë

- 21 Specifikimet e produktit

Informacion mbi sigurinë


- 22 Parandalimi i humbjes së dëgjimit
- 22 Informacion shtesë
- 22 Ekspozimi i radiofrekuencës
- 23 Masat paraprake të lidhjes me Bluetooth
- 23 Informacion mbi baterinë
- 23 Markat tregtare të regjistruara dhe licencat
- 24 Njoftim për softuerin me burim të hapur

Udhëzuesi i pastrimit

- 25 Pastrimi i kufjeve:


Eksplorimi i produktit

Kutia e karikimit



- A** Drita e humorit: Kur hapni kutinë e karikimit, drita e humorit ndizet dhe fiket.
- B** Porta e kutisë së karikimit: Mund të karikoni një pajisje.
- C** Llamba LED UVnano: Nëse e karikoni pajisjen me kufjet e vendosura dhe kapakun e mbyllur, llamba LED UVnano funksionon për 10 minuta.
- D** Treguesi i statusit të baterisë (lart): Mund ta kontrolloni statusin e baterisë së kufjeve ose kutisë së karikimit.
- E** Treguesi i UVnano (poshtë): Treguesi UVnano është blu kur drita LED UVnano është në punë.
- F** Termialet e karikimit të kufjeve: Ju mund t'i karikoni kufjet duke i vendosur në kutinë e karikimit.

Kufjet



- (A) Mikrofoli
- (B) Rrjeta e altoparantit (mikrofoli)
- (C) Fusha me prekje
- (D) Termialet e karikimit të kufjeve


✓ Vini re

- Kini kujdes që të mos ketë substanca të huaja mbi termialet e karikimit të kufjeve.

Lidhja me Bluetooth për përdorim

Lidhja e smartfonit me kufjet përmes Bluetooth

- 1 Aktivizoni funksionin Bluetooth® të smartfonit ose pajisjes që dëshironi të lidhni.
- 2 Hapni kapakun me kufjet të vendosura në kutinë e karikimit. Treguesi blu i statusit të baterisë në pjesën balllore pulson. Nëse drita blu e statusit të baterisë nuk pulson ose nëse dëshironi të lidhni një pajisje të ndryshme nga ajo e lidhur tashmë, prekni dhe mbani prekur fushën me prekje në kufjen e majtë ose të djathtë për 3 - 5 sekonda.



- 3 Kur dritarja njoftuese e lidhjes së Çiftimit të shpejtë të shfaqet në fund të ekranit të smartfonit, prekni lehtë mbi të për t'u lidhur.
 - Mbështetet vetëm Android™ 6.0 ose version më të ri dhe kërkohen cilësimet e Bluetooth® dhe të informacionit të vendndodhjes së pajisjes celulare.
- 4 Nëse dritarja njoftuese e lidhjes nuk shfaqet, kërkoni dhe lidhni [TONE-T60Q] në menunë Bluetooth® të smartfonit. (Për përdoruesit e iOS ose Android 5.0 ose version më të ulët)
 - TONE-T60Q_LE nuk është një emër i vlefshëm i modelit në listën e pajisjeve të lidhjes me Bluetooth®. Kontrolloni emrin e modelit që po përdorni dhe lidhni me emrin e modelit i cili nuk përmban "LE".
 - Nëse emri i modelit të kufjeve shfaqet në mënyrë jo normale në pajisjen Android, ju lutemi ndryshoni emrin e modelit në menunë Bluetooth® të cilësimeve të pajisjes së lidhur.

✓ Vini re

- Për të lidhur një pajisje tjetër, kryeni sërish procedurat më sipër.

Lidhje të Shumëfishta

Nëse përdorni aplikacionin LG TONE Free, mund të lidhni dhe përdorni dy pajisje, si p.sh. një smartfon dhe një kompjuter njëkohësisht.

- 1 Ju lutemi aktivizoni "Multi-Point & Multi-Pairing" në aplikacionin LG TONE Free.
- 2 Vendosni kufjet në kutinë e karikimit dhe kryeni procedurat e lidhjes në të njëjtën mënyrë.
- 3 Pajisja ekzistuese e lidhjes bëhet "pajisja kryesore e lidhjes" dhe pajisja e sapo lidhur bëhet "pajisja ndihmëse e lidhjes".
- 4 Ju mund ta përdorni funksionin e shumë-lidhjeve në mënyrë më të përshtatshme në cilësimet e detajuara "Multi-Point & Multi-Pairing".

✓ Vini re

- Kur të dy pajisjet lidhen në të njëjtën kohë, funksioni kryesor funksionon bazuar mbi "pajisjen kryesore të lidhjes".
-

Rilidhja automatike

Nëse hapni kutinë e karikimit të kufjeve, ato lidhen automatikisht me pajisjen e fundit të lidhur dhe të përdorur. (Nëse pajisja nuk mund të gjendet, ajo kalon në regjimin e lidhjes.)

Nëse rilidhja automatike nuk është kryer, kërkoni për kufjet në pajisjen që do të lidhni dhe lidhni ato manualisht.


Dëgjimi i zërit me kufje

I Mbajtja në vesh e kufjeve


1 Hiqni kufjet nga kutia e karikimit dhe vendosini ato në mënyrë të përshtatshme në vesh.

✓ Vini re


- Nëse përdorni një xhel kufjesh veshi me madhësi e cila i përshtatet veshëve tuaj, mund ta përmirësoni performancën e anulimit aktiv të zhurmës (ANC). Më pas mund të dëgjoni muzikë me cilësi të pasur tingulli.




2 Nëse i vini kufjet siç duhet, mund të dëgjoni një tingull të zbulimit të konsumit.






*Për të zëvendësuar xhelin (veshjen) e kufjeve, vendosni në një drejtim formën e vrimës së xhelit të kufjeve me zgjatimin e kufjeve dhe fiksojeni mirë.



Dëgjimi i muzikës







| Funksioni | Si ta përdorni |
|---------------------|--|
| Luaj/Ndalo |  : Prekni një herë kufjen e majtë ose të djathtë. |
| Kontrulli i volumit |  : Prekni dy herë kufjen e majtë (ulja e volumit) ose të djathtë (ngritja e volumit). |
| Kënga e radhës |  : Prekni tri herë kufjen e majtë ose të djathtë. |

✓ Vini re

- Mund të ndryshoni mënyrën se si ta përdorni funksionin në cilësimet e fushës me prekje të aplikacionit LG TONE Free.

Pranimi i telefonatës



| Funksioni | Si ta përdorni |
|---------------------------|--|
| Pranimi i telefonatave |  : Prekni një herë kufjen e majtë ose të djathtë. |
| Ndërprerja e telefonatave |  : Prekni dy herë kufjen e majtë ose të djathtë. |
| Refuzimi i telefonatave |  : Prekni dhe mbani prekur kufjen e majtë ose të djathtë. |

Funksioni i telefonatave të smartfonit

| Funksioni/Statusi | Përshkrimi |
|---|---|
| Pranimi i telefonatave/Kur pranoni telefonata | Prekni një herë kufjen e majtë ose të djathtë. |
| Bërja e telefonatave/Në pritje për t'u përdorur | Kur bëni një telefonatë nga smartfoni juaj, telefonata lidhet automatikisht me kufjet. Nëse prekni një herë kufjen e majtë ose të djathtë, telefonata aktuale kalon në gjendjen e gatishmërisë dhe kështu mund të merrni një telefonatë hyrëse gjatë një telefonate. |
| Pranimi i një telefonate tjetër gjatë një telefonate/Gjatë një telefonate | Nëse një telefonatë ekzistuese është në pritje, mund ta përfundoni telefonatën aktuale në smartfonin tuaj. (Kjo funksionon ndryshe në varësi të cilësimeve të smartfonit.) |


Dëgjimi i tingullit të ambientit/Anulimi aktiv i zhurmës (ANC)

Dëgjimi i tingullit të ambientit



Funksioni i dëgjimit të tingullit të ambientit ju bën të dëgjoni tinguj të jashtëm, në mënyrë që të jeni të vetëdijshëm për mjedisin dhe rreziqet tuaja.

Anulimi aktiv i zhurmës (ANC)



Funksioni i anulimit aktiv të zhurmës (ANC) bllokon tingujt e jashtëm gjatë përdorimit. Prandaj, përdoreni atë kur nuk dëshironi të shqetësoheni gjatë dëgjimit të muzikës ose shikimit të një videoje.


- **Nëse prekni dhe mbani kufjen e majtë ose të djathtë**, mund të kaloni midis anulimit aktiv të zhurmës (ANC) dhe dëgjimit të tingullit të ambientit.
- Ju mund t'i vendosni funksionet e dëgjimit të tingullit të ambientit ose të anulimit aktiv të zhurmës (ANC) në aplikacionin LG TONE Free.
- Mund të vendosni regjimin e dëgjimit dhe regjimin e bisedës në aplikacionin LG TONE Free.
- Kur përdorni funksionin e dëgjimit të tingullit të ambientit ose funksionin e anulimit aktiv të zhurmës (ANC), koha e disponueshme është më e shkurtër sesa kur është e fikur.
- Funksioni i dëgjimit të tingullit të ambientit ose i anulimit aktiv të zhurmës (ANC) funksionon kur jeni në gatishtëri/duke dëgjuar muzikë/gjatë një telefonate.
 - ANC do të thotë anulimin aktiv i zhurmës.

⚠ Kujdes

- Kur ekzekutohet regjimi i tingullit të ambientit, mund të dëgjoni papritmas një tingull të lartë të ambientit. Kushtojini vëmendje sigurisë kur përdorni jashtë anulimin aktiv të zhurmës (ANC).
-

Karkimi

| Karikimi nëpërmjet kabllot



Nëse lidhni kabllon e karikimit, statusi i karikimit shfaqet në kutinë e karikimit.

✓ Vini re

- Kufjet dhe kutia e karikimit karikohen njëkohësisht.
- Terminali i karikimit të kutisë së karikimit nuk e mbështet funksionin e furnizimit me energji elektrike për pajisje të tjera si smartfoni.

Përshkrimi mbi UVnano

Kutia e karikimit ka një llambë LED të integruar UVnano për të mbajtur të pastra kufjet.

Nëse e karikoni pajisjen me kufjet e vendosura dhe kapakun e mbyllur, llamba LED UVnano funksionon për 10 minuta.

* UVnano është një fjalë e përbërë e UV dhe nanometër, njësi e UV.



✓ Vini re

- Treguesi UVnano është blu ndërsa llamba LED UVnano është në punë.
- Kutia e karikimit UVnano heq deri në 99,9% të mikrobeve të dëmshme nga xheli i kufjeve të veshit.
- Produkti i bardhë mund të ketë një ngjyrë të ndryshme në pjesën e kontaktit të llambës LED UVnano, por nuk ka asnjë problem me performancën.


⚠ Kujdes

- Ju lutemi, vini re se temperatura e kufjeve mund të rritet ndërsa llamba LED UVnano është në punë.

Kontrolli i gjendjes së baterisë

Nëse hapni kutinë e karikimit shfaqet statusi i baterisë së kufjeve.

Statusi i baterisë së kutisë së karikimit shfaqet kur kufjet nuk janë të vendosura.



| Treguesi i statusit të baterisë | Gjendja e nivelit të baterisë (karikuesi nuk është i lidhur) / Statusi i karikimit (karikuesi është i lidhur) |
|---------------------------------|---|
| E kuqe | 20% ose më pak / Karkimi |
| E verdhë | 20% ~ 80% / - |
| Jeshile | 80% ose më shumë / Karikuar plotësisht: |

✓ Vini re

- Nëse mbyllni kutinë e karikimit shfaqet statusi i baterisë së kutisë së karikimit.
- Kur bateria në kutinë e karikimit është konsumuar plotësisht, kufjet nuk mund të ndizen ose fiken. Ju lutemi karikoni kutinë e karikimit.

Treguesi i statusit të baterisë

| Statusi | Funksionimi |
|---|--|
| Regjimi i kërkimit të Bluetooth® | Treguesi blu i statusit të baterisë pulson. |
| Bateria 20% ose më pak | Treguesi i kuq i statusit të baterisë ndizet dhe fiket. |
| Bateria 20% ~ 80% | Treguesi i verdhë i statusit të baterisë ndizet dhe fiket. |
| Bateria 80% ose më shumë | Treguesi jeshil i statusit të baterisë ndizet dhe fiket. |
| Kur ndodh një gabim karikimi | Treguesi i kuq i statusit të baterisë pulson. |
| Ndërsa bateria është duke u karikuar (karikuesi i lidhur) | Treguesi i kuq i statusit të baterisë ndizet. |
| Karikimi i baterisë ka përfunduar (karikuesi i lidhur) | Treguesi jeshil i statusit të baterisë ndizet. |

Lidhja me aplikacionin Bluetooth

Lidhja me aplikacionin LG TONE Free

- 1** Kërkoni për "LG TONE Free" në platformën Google Play Store ose App Store në smartfonin tuaj ose skanoni më poshtë kodin QR për të instaluar aplikacionin LG TONE free.
- 2** Ekzekutoni aplikacionin për të përdorur funksione të ndryshme (kontrolli i baterisë së kufjeve, njoftimi zanor, ndryshimi i regjimit të barazimit, kontrolli i informacionit mbi vendndodhjen e lidhjes së fundit, kërkimi i kufjeve të mia me valë, etj.) Mbështetet vetëm Android 7.0 dhe iOS 13 ose versione më të reja.



<Android>



<iOS>

Masat paraprake të sigurisë

I Njoftimet dhe Paralajmërimet e Sigurisë

"Masat paraprake të sigurisë" në vijim janë për të parandaluar rreziqet ose dëmtimet e papritura, prandaj sigurohuni t'i lexoni ato me kujdes.

'Masat paraprake të sigurisë' ndahen në 'Paralajmërim' dhe 'Kujdes'.

⚠ PARALAJMËRIM: Moszbatimi i udhëzimeve mund të rezultojë në lëndime serioze ose vdekje.

⚠ Kujdes: Mosrespektimi i udhëzimeve mund të rezultojë në lëndime të lehta ose dëmtim të produktit.

-
- ⚠ Paralajmërim**
- Mos e rrëzoni produktin nga ndonjë lartësi e madhe.
 - Sigurohuni që produkti të mos bjerë në kontakt me alkoolin ose benzenin.
 - Mos e lini produktin në vend me lagështirë apo me pluhur.
 - Mos vendosni objekte të rënda mbi produkt.
 - Kufjet janë testuar në kushte të kontrolluara laboratorike me një vlerësim IPX4. Rezistente ndaj spërkatjes me ujë. Thajini para përdorimit. Mos i karikoni kur janë të lagura. Kutia e karikimit nuk është testuar për IPX4.
-

- ⚠ Kujdes**
- Mos e çmontoni, rregulloni ose riparoni produktin.
 - Mos e vendosni produktin pranë burimeve të temperaturës së lartë ose pranë materialeve që ndizen shpejt.
 - Produkti mund të dëmtohet nëse përdorni ndonjë karikues që nuk përputhet me të.
 - Mbani komponentët e vegjël të produktit larg foshnjave ose fëmijëve.
 - Sigurohuni që në fishat e karikuesit (porta e karikimit dhe spina e furnizimit me energji) të mos futen sende të huaja. Objektet e huaja në fishat e karikuesit mund të shkaktojnë zjarr ose goditje elektrike.
 - Nëse keni ndonjë pajisje mjekësore të implantuar, flisni me doktorin përpara se ta përdorni këtë pajisje.
 - Për hir të sigurisë suaj, mos e hiqni baterinë e integruar të produktit.
 - Ky produkt ka një bateri të integruar dhe kjo bateri nuk mund të hiqet dhe as të zëvendësohet.
 - Nëse e zëvendësoni baterinë pa autorizim ose nëse nuk e zëvendësoni si duhet, ajo mund të shpërthejë.
 - Bateria me litium-jon është një komponent i rrezikshëm i produktit, që mund të shkaktojë lëndime fizike.
 - Nëse baterinë e zëvendëson ndonjë profesionist i pakualifikuar, pajisja juaj mund të dëmtohet.
 - Mos e asgjësoni baterinë pa zbatuar rregulloret. Ndiqni procedurat lokale për asgjësimin e baterive.
 - Për të mos konsumuar energji të panevojshme, shkëputeni pajisjen pasi të karikohet plotësisht. Për të karikuar pajisjen, përdorni gjithmonë një prizë tek e cila mund të mbërrini me lehtësi.
 - Rrezik zjarri ose shpërthimi nëse bateria zëvendësohet me një lloj të gabuar baterie.
 - Mos e ruani dhe transportoni në tryzni nën 11,6 kPa dhe 15 000 m mbi nivelin e detit.
-

⚠ Kujdes

- Zëvendësimi i baterisë me një lloj të gabuar baterie mund të përbëjë shkelje të një mase mbrojtëse (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive me litium).
 - Hedhja e baterisë në zjarr ose furrë të nxehtë, thyerja mekanike apo prerja e baterisë, mund të rezultojë në shpërthim.
 - Lënia e baterisë në një mjedis me temperaturë jashtëzakonisht të lartë mund të rezultojë në shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit që ndizet shpejt.
 - Bateria që i nënshtrohet trysnisë jashtëzakonisht të ulët të ajrit mund të rezultojë në shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit që ndizet shpejt.
 - Mos i hidhni pa kujdes bateritë e vjetra. Një veprim i tillë mund të shkaktojë shpërthim ose zjarr. Metoda e asgjësimit të baterive mund të ndryshojë sipas vendit dhe rajonit. Asgjësojeni në mënyrën e duhur.
-

| Masat paraprake kur përdorni produktin

Fshijeni produktin nëse ka qenë i ekspozuar ndaj djersës së shumtë.

Mbani të pastër zonën rreth kufjeve.

Nëse mbani kufje për një kohë të gjatë, kjo mund t'ju shkaktojë dhimbje, dhe nëse lagështia në vesh mbetet gjatë, mund t'ju shkaktojë probleme me lëkurën.

Çfarë duhet të kontrolloni përpara se të raportoni ndonjë keqfunksionim



Zgjidhja e problemeve

Nëse vini re simptomat e mëposhtme gjatë përdorimit të produktit, ju lutemi verifikojini sërish. Ato mund të mos jenë keqfunksionim.

| Simptoma | Shkaku dhe zgjidhja |
|---|--|
| Nëse produkti nuk ndizet | <ul style="list-style-type: none">Kontrolloni nivelin e baterisë dhe karikojeni atë. |
| Nëse një telefonatë s'mund të bëhet me anë të kufjeve | <ul style="list-style-type: none">Nëse smartfoni juaj nuk e mbështet funksionin pa duar, nuk mund ta përdorni funksionin e telefonatës.Kontrolloni nivelin e baterisë dhe karikojeni atë. |
| Nëse nuk mund t'i regjistroni kufjet në smartfon | <ul style="list-style-type: none">Kontrolloni nëse pajisja është nderur duke hapur kapakun e kutisë së karikimit.Kontrolloni që kufjet të kenë kaluar në regjimin e kërkimit.<ul style="list-style-type: none">Nëse prekni dhe mbani fushën me prekje në anën e majtë ose të djathtë të kufjeve për 3 deri në 5 sekonda me kufjet në kutinë e karikimit, ajo kalon në regjimin e kërkimit. |
| Nëse i keni zëvendësuar kufjet ose keni probleme me funksionimin (rikthim në gjendjen fillestare të fabrikës). | <ul style="list-style-type: none">Prekni dhe mbani fushën me prekje majtas ose djathtas kufjeve për më shumë se 10 sekonda me kufjet në kutinë e karikimit.<ul style="list-style-type: none">Treguesi i gjendjes së baterisë së kutisë së karikimit pulson me ngjyrë të kuqe dhe rikthimi në gjendjen fillestare të fabrikës avancon. Ju lutemi lidhni sërish kufjet pas rikthimit në gjendjen fillestare të fabrikës. |

Shtojcë

Specifikimet e produktit

| Të përgjithshme | Përshkrimi |
|--|--|
| Specifikimet e Bluetooth-it | V 5,3 (HSP/HFP/A2DP/AVRCP) |
| Bateria | Kufjet : 3,85 V / 51 mAh, bateri Litium-jon kutia e karikimit : 3,7 V / 390 mAh, bateri litium-jon |
| Kohëzgjatja e dëgjimit të muzikës nga kufjet dhe me kutinë e karikimit | Drita ANC është e fikur : Deri në 9 dhe deri në 29 orë* me ANC aktive : Deri në 5 dhe deri në 16 orë* |
| Koha e karikimit | Kufjet: brenda një ore / kutia e karikimit: brenda 2 orësh Karikimi i shpejtë: 5 min karikim zgjat deri në 60 min përdorim* • Kur karikimi bëhet me kablo në temperaturën e dhomës |
| Tensioni nominal hyrës | Kufjet : 5 V  , 102 mA Kutia e karikimit: 5 V  , 500 mA |

*Koha e përdorimit mund të ndryshojë në varësi të smartfonit të lidhur ose funksioneve të përdorimit, cilësimeve, fuqisë së sinjalit, temperaturës së punës, përdorimit të brezit të frekuencës dhe metodave të tjera të përdorimit.

| | |
|-----------------------------------|--|
| Temperatura e funksionimit | 0°C ~ +40°C |
| Lagështia e ambientit ku përdoret | 5 % ~ 60 % |
| Dimensionet (mm) / Peshë (g) | Kufjet: 21,5 mm (gjerësi) x 27,7 mm (gjatësi) x 24,9 mm (lartësi)/5,1 g (një kufje) Kutia e karikimit: 54,5 mm (gjerësi) x 54,5 mm (gjatësi) x 29,6 mm (lartësi)/35,9 g |
| Vargu i frekuencës | 2402 MHz deri 2480 MHz |

*Kohëzgjatja e përdorimit mund të ndryshojë në varësi të pajisjes celulare të lidhur, veçorive që përdoren, cilësimeve, fuqisë së sinjalit, temperaturës së funksionimit, brezit të frekuencës dhe metodave të tjera të përdorimit.

Informacion mbi sigurinë

Parandalimi i humbjes së dëgjimit



Nëse volumi i kufjeve është shumë i lartë, mund të përjetoni humbje të përhershme të dëgjimit. Vendosni volumin e zërit në një nivel të sigurt. Mund të tingëllojë normale, por nëse dëgjoni shpesh tinguj me zë të lartë që mund të dëmtojnë dëgjimin tuaj, veshët tuaj mësohen me të me kalimin e kohës.

Nëse ndjeni zhurmë në veshët tuaj ose dëgjoni zë të dobët, ndaloni së dëgjuari dhe bëni një test dëgjimi. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më shpejt mund të dëmtohet dëgjimi juaj.

Për të mbrojtur dëgjimin tuaj, ekspertët ju sugjerojnë të bëni sa më poshtë.

- Kufizoni kohën për përdorimin e kufjeve me volum të lartë.
- Shmangni zakonin për ta rritur volumin për të mos dëgjuar zhurma të forta rreth jush.
- Nëse nuk mund t'i dëgjoni njerëzit pranë, ulni volumin.

Për mënyrën e vendosjes së kufirit maksimal të volumit të pajisjes së lidhjes, referojuni manualit të përdorimit të dhënë me pajisjen e lidhjes.

Informacion shtesë

Shkronja e markës tregtare dhe logoja e **Bluetooth®** janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. Përdorimi i të gjitha markave tregtare është subjekt i marrëveshjes së licencës.

Logot e Android, Google Play dhe Google Play, si dhe markat dhe logot e tjera të ngjashme janë marka tregtare të Google LLC.



Ekspozimi i radiofrekuencës

Këto kufje stereo LG me Bluetooth janë një transmetues dhe marrës radioje. Kur janë në punë, ato komunikojnë me një pajisje celulare të pajisur me Bluetooth duke marrë dhe transmetuar fusha elektromagnetike të radiofrekuencës (RF) (mikrovalë) në intervalin e frekuencës 2402 deri në 2480 MHz.

Kufjet tuaja me Bluetooth janë projektuar për të funksionuar në përputhje me udhëzimet dhe kufijtë e ekspozimit ndaj RF të vendosura nga autoritetet kombëtare dhe agjencitë ndërkombëtare shëndetësore kur përdoren me çdo telefon celular të përputhshëm.

Massat paraprake të lidhjes me Bluetooth

Mjediset e mëposhtme ndikojnë në diapazonin dhe marrjen e sinjaleve të Bluetooth:

- Kur muret, metalet, trupat e njeriut ose pengesa të tjera ekzistojnë midis pajisjes me Bluetooth dhe pajisjes së lidhur.
- Kur pajisjet që përdorin sinjale me frekuencë 2,4 GHz (LAN me valë, telefona me valë, furra me mikrovalë, etj.) vendosen pranë pajisjeve që po përdoren.
- Kur përdorni një pajisje me Bluetooth (TV, laptop, etj.) përveç telefonit celular, cilësia e zërit mund të ndikohet nga specifikimet dhe performanca e pajisjes.

Informacion mbi baterinë

Një bateri e karikueshme ka një jetë të gjatë shërbimi nëse trajtohet siç duhet. Një bateri e re ose një bateri që nuk është përdorur për një periudhë të gjatë kohore mund të ketë kapacitet të reduktuar herët e para që përdoret.

Mos e ekspozoni baterinë në temperatura ekstreme, asnjëherë mbi +50°C ose nën -10°C. Për kapacitet maksimal të baterisë, përdorni baterinë në temperaturën e dhomës. Nëse bateria përdoret në temperatura të ulëta, kapaciteti i baterisë do të reduktohet. Bateria mund të karikohet vetëm në temperatura midis 0° dhe +45°.

Markat tregtare të regjistruara dhe licencat

Të gjitha markat tregtare dhe emrat tregtarë janë pronë e pronarëve përkatës.



Shprehja "Made for iPhone" do të thotë që një aksesori elektronik është krijuar për t'u lidhur posaçërisht me iPhone, përkatësisht dhe është certifikuar nga zhvilluesi për të përmbushur standardet e performancës së Apple. Kompania Apple nuk mban përgjegjësi për përdorimin e kësaj pajisjeje ose për pajtueshmërinë e saj me standardet e sigurisë dhe me rregulloret e mbrojtjes. Ju lutemi, vini re se përdorimi i këtij aksesori me pajisje iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.

I Njoftim për softuerin me burim të hapur

Për të marrë kodin e burimit nën GPL, LGPL, MPL dhe licenca të tjera me burim të hapur që kanë detyrimet për të zbuluar kodin e burimit që ndodhet në këtë produkt, dhe për të aksesuar të gjitha kushtet e referuara të licencës, njoftimet për të drejtën e autorit dhe dokumentet e tjera përkatëse, ju lutemi vizitoni faqen <https://opensource.lge.com>.

"LG Electronics" do t'ju ofrojë po ashtu kodin me burim të hapur në një CD-ROM me një tarifë që mbulon koston e kryerjes së një shpërndarje të tillë (si p.sh. kostoja e materialit, transportit dhe administrimit) pas kërkesë me email në opensource@lge.com.

Kjo ofertë është e vlefshme për këdo që merr këtë informacion për një periudhë prej tre vjetësh nga dërgesa jonë e fundit e këtij produkti.



GRUP I RREZIKUT 3

PARALAJMËRIM: UV-C (rrezatimi ultravjollcë) I EMITUAR NGA KY PRODUKT. SHMANGNI EKSPOZIMIN E SYVE DHE LËKURËS NDAJ PRODUKTIT TË PAMBROJTUR.

PARALAJMËRIM: Nëse nuk e karikoni ose nuk e hapni kutinë e karikimit, funksioni UV nuk punon.

Simbolet

~ : Rrymë alternative (AC).

— : Rrymë direkte (DC).

☐ : Pajisje e klasit II

⏻ : Gjendja e rrymës në regjimin e pritjes

⚡ : Në pajisje ka rrymë elektrike.

⚡ : Tension i rrezikshëm

Gabimet drejtshkrimore ose përmbajtja e pasaktë në këtë manual përdorimi mund të ndryshohen pa njoftim paraprak nga LG Electronics.

Niveli dalës do të kthehet automatikisht në një nivel dalës që nuk e kalon RS1 kur pajisja është e fikur.


Udhëzuesi i pastrimit

Pastrimi i kufjeve:

Pastroni vrimën e altoparantit dhe vrimën e ajrosjes në mënyrë që të mos jenë të bllokuara nga substancat e huaja (sebum, dyllë veshësh etj.).

* Nëse vrima e altoparantit dhe vrima e ajrosjes janë të bllokuara, volumi mund të jetë i ulët dhe mund të shkaktohet zhurmë dhe performanca e anulimit të zhurmës mund të ulët.

1 Së pari, ndani majën e kufjes dhe hiqni substancat e huaja brenda majës së kufjes.



2 Më pas, pastroni vrimën me një furçë të butë ose tampon pambuku për ta pastruar atë.

Vrima e ajrosjes
(Ajo mund të jetë e vendosur ndryshe ose të mos ekzistojë, në varësi të modelit.)

